



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr.1 datë 23.01.2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 23/01/ 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 29/01/2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino SELIMI

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ





BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1 prot.

Tepelenë, më 23.01.2026

Procesverbal

PROCESVERBAL

I mbajtur më datë **23.01.2026**, ora **12:00**, në zyrën e Këshillit Bashkiak Tepelenë, ku u zhvillua mbledhja e **Kryesisë së Këshillit** për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes së radhës.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

1. Z. Arben Gumeni
2. Z. Vladimir Bakiaj
3. Znj. Mjaftoni Zeraj
4. Dino Selimi

Takimin e hapi Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni, i cili përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se mbledhja zhvillohej për miratimin paraprak të rendit të ditës dhe përcaktimin e datës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak për muajin Janar.

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen e ardhshme:

1. Rendi i ditës si më poshtë: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 22.12.2025.
3. **Projektvendim:** : “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin dhjetor 2025”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin dhjetor 2025”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor”.

6. **Projektvendim:** "Për miratimin e planit operacional vjetor të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026".

7. **Projektvendim:** "Për zhvillimin e pronës në fshatrat Salari, me numër kadastral 1094/4, 1094/5; Zona Kadastrale nr. 3252, Gusmar me numër kadastral 764, 134, 131, 182, 132, Zona Kadastrale nr. 1913, Progonat me Numër Kadastral 735, 752, 717, 721, 722, 729, 728, 702, 700, 625, 630, 636, 399, 649, 659, 682, 686, Zona Kadastrale nr. 3057, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit, të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin "e-albania".

8. **Projektvendim:** "Për zhvillimin e pronës në fshatin Dragot me numër kadastral, 392 Zona Kadastrale nr. 1529, me përfitues Bashkinë Tepelenë dhe zhvillues CESVI Albania (OJF) si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit të aplikojë".

9. **Projektvendim:** "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë"

10. **Projektvendim:** "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë".

11. **Projektvendim:** "Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë".

12. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore".

13. Çështje të tjera.

14. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Pas diskutimeve, të gjitha pikave të mësipërme Kryesia e Këshillit vendosi me unanimitet që mbledhja e ardhshme e Këshillit Bashkiak Tepelenë të zhvillohet më datë **29.01.2026**, ora **11:00**.

Kryetari deklaroi mbylljen e mbledhjes.

KRYESIA E KËSHILLIT

KRYETARI KËSHILLIT



SEKRETARI KËSHILLIT

Valbona Çela

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

www: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al

Znj. Mjaftoni Zeraj 
Z. Vladimir Bakiaj 
Z. Dino Selimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr.1 datë 23.01.2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 23/01/ 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 29/01/2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino SELIMI

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ

